

Shenjat para Ditës së Gjykimit

Imam Ibn Kethir

Tymi i cili do të shfaqet nga fund i kohës

Mesruk tha: "Ndërsa një burrë po u mbante fjalim banorëve të Kindes, tha: 'Do të ketë Tym në Ditën e Ringjalljes, i cili do t'ua marrë hipokritëve dëgjimin dhe të parët, kurse besimtarët do të ndjejnë sikur janë të ftohur'. Në u tmerruam, kështu që shkuaam te Ibn Mes'ud, i cili po rrinte mbështetur. Kur dëgjoi për këtë, u hidhërua shumë dhe u ul e tha: 'O njerëz, kushdo që di diçka, le ta thotë; kushdo që s'di, le të thotë 'Allahu e di më së miri'. Është pjesë e dijes që, kur personi të mos dijë diçka, të thotë 'Allahu e di më së miri'".

Allahu i patëmeta i tha peygamberit [salallahu alejhi ue selam]:

« **Thuaj: 'Nuk kërkoj për këtë [Kuran] kurrfarë shpërblimi e as nuk shtirem »**
[Sad, 38-86]

"Kurejshët po tregoheshin të ngadaltë në pranimin e Islamit, kështu që peygamberi [salallahu alejhi ue selam] u lut kundër tyre duke thënë: 'O Allah, më ndihmo kundër atyre duke dërguar shtatë vjet uri si ato të Jusufit'. Ata u goditën nga një vit urie në të cilin gati u shkatërruan dhe hanin cofëtina e eshtra. Ata nisën të shihnin diçka si tym mes qiellit dhe tokës. Ebu Sufjan erdhi dhe tha: 'O Muhamed, ti erdhe të na urdhërosh për marrëdhënie të mira me të afërmit, kurse populli po mbaron. Lutu që Allahu t'u ndihmojë atyre". Atëherë, Ibn Mes'ud recitoi:

« **Pritni Ditën kur qielli të sjellë një tym [mjegull] të dukshëm, i cili do t'i mbështjellë njerëzit. Ky do të jetë një dënim të rëndë. [Ata do të thonë] 'Zoti ynë! Na e largo këtë dënim, se ne vërtet po besojmë! E si të përfitojnë ata nga Shpallja, kur u pat ardhur i Dërguari t'ua shpjegojë gjërat qartë, kurse ata ia kthyen shpinën duke thënë: 'I mbikëqyrur [nga dikush tjetër], i xhindosur! Ne vërtet që do ta largojnë dënimin për një kohë, por ju do të ktheheni prapë [në rrugët tuaja]' » [ed-Dukhan, 10-15]**

Ibn Mes'ud tha: "A do të largohet dënimi prej tyre në ahiret që ata të kthehen në mosbesimin e tyre?" Allahu i patëmeta thotë:

« **Ditën kur Ne do t'i kapim me një dënim të ashpër. Vërtet, ne do të marrim hak »** [ed-Dukhan, 16]

« **... së shpejti do të vjen e pashmangshmja [dënimi] »** [el-Furkan, 77]

Këto ajete i referohen Ditës së Bedrit. Allahu i lartësuar thotë:

« Elif-Lam-Mim. Romakët u mposhtën në një vend të afërt, por ata, mbas kësaj disfate, së shpejti, brenda disa viteve, do të dalin fitimtarë » [er-Rum, 1-3] [el-Buhari]

Sugjerimi i folësit - se Tymi do të ndodhë në Ditën e Ringjalljes – e hidhëroi Ibn Mes'udin. Pra, Tymi do të shfaqet para Ditës së Ringjalljes. Ai do të jetë një nga Shenjat: Bisha, Dexhalli, Tymi, Jexhuxhët e Mexhuxhët, siç tregojnë hadithet e transmetuara nga Ebu Sariha, nga Ebu Hurejre dhe nga sahabë të tjerë. Siç përmendet në hadithe të vërteta, zjarri i cili do të shfaqet para Ditës së Ringjalljes, do të shpërthejë nga drejtimi i Adenit dhe do t'u grahë njerëzve për tek tubimi përfundimtar i tyre. Ai do lëvizë me ta dhe do të ndalet me ta, dhe do të përpijë këdo që mbetet mbrapa.